

Informatat më të fundit në Lidhje me Shqyrtimin e çmimeve

Si vazhdimësi e njoftimit për shqyrtimin e çmimeve të KEK-ut, të lëshuar me 14 mars 2006, Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji (ZRRE) njofton se do të publikoj një numër punimesh pozicionuese në lidhje me aspekte të ndryshme të kalkulimit të çmimeve të KEK-ut. Punimi i parë, për propozimin e kthimit të lejuar të të ardhurave të (MPPK- Mesatarja e Ponderuare Kapitalit) e KEK-u dhe KOSTT, do të publikohet në ueb-faqen e ZRRE-së (www.ero-ks.org) duke filluar nga 31 korriku 2006 dhe komentet me shkrim do të pranohen deri me 8 gusht 2006.

Punime tjera pozicionuese do të publikohet gjatë gushtit 2006. Detale të plota për të hyrat e propozuara që do të mirren nga KEK-u pritet që të jenë në dispozicion deri me 25 gusht 2006 dhe një dëgjim publik në lidhje me këto është planifikuar të mbahet në javën e parë të shtatorit 2006. Një plan i rishqyrtuar për implementim dhe një orar për shqyrtimin e çmimeve është në dispozicion në ueb-faqen e ZRRE-së.